

Gjykata Supreme e Kosovës
API.-KZI. Nr. 7/2011
Prishtinë
21 shkurt 2012

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës mbajti seancën e kolegjit në pajtueshmëri me Nenin 26 paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), dhe Nenin 15.4 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhja e Lëndëve dhe Caktimi i Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (LmK) më 14 shkurt 2012 në ndërtesën e Gjykatës Supreme të Kosovës në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si Kryetar kolegji dhe gjyqtares së EULEX-it Anne Kerber si edhe gjyqtarët e Gjykatës Supreme Nazmije Ibrahim, Gyltene Sylejmani dhe Salih Toplica si anëtarë të kolegjit,

Dhe me Holger Engelmann si procesmbajtës,

Në praninë e

Prokurorit Publik të Shtetit Jusuf Mezini, Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSHK),

Avokatit mbrojtës B.E. për të pandehurin A.O.,

Në lëndën penale me numër API.-KZI. Nr. 7/2011 kundër të pandehurit:

A.O., emri i të atit XXX, emri i vajzërisë së nënës XXX, i lindur më XXX në fshatin XXX komuna XXX, me vendbanim në të njëjtin vend, Shqiptar i Kosovës, i martuar, baba i një fëmije, ka të mbaruar shkollën e mesme, teknik i makinerisë, i papunë, me kushte mesatare ekonomike,

I dënuar nga shkalla e parë me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në lëndën P. Nr. 64/2005 të datës 30 nëntor 2009 dhe e regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të njëjtën ditë; i pandehur është shpallur fajtor për **Vrasje të Rëndë** në pajtueshmëri me Nenin 147 paragrafi 1 pikat 3 dhe 8 të Kodit të Procedurës Penale (KPK); sepse i pandehuri pasditen e datës 28 tetor 2004 në fshatin Bardhe i Madh në komunën e Fushë Kosovës, në vendin e quajtur “Te Kalaja” në mënyrë mizore apo dinake dhe me qëllim të fshehjes të veprës tjetër penale të mashtrimit, me revolver të markës së pa definuar, të kalibrit 9x19 mm, me dëshirë privon nga jeta tani të ndjerin K.Z. 20 vjeç, nga fshati Halilaq, duke qëlluar 12 herë në trupin e tij, prej të cilave 10 ishin plagë nga arma e zjarrit dhe dy të tjera plagë të depërtimit nga arma e zjarrit, duke synuar kryesisht pjesën kurrizore të trupit, të cilat plagë shkaktuan vdekjen e viktimës të verifikuar në raportin e autopsisë të datës 24 dhjetor 2004, nga të cilat plagë K.Z. vdes menjëherë dhe kufoma e tij është fshehur me ndihmën e një bashkë të akuzuari tjetër në një gropë me madhësi prej 3.40m x 4.80m, të mbushur me ujë dhe të mbuluar me qese plastike dhe dhe’;

Dhe është dënuar me 30 (tridhjetë) vjet burgim në pajtueshmëri me Nenin 37 të lexuar me Nenin 147 paragrafi 1, pikat 3 dhe 8 të KPK, ndërsa sipas Nenit 73 të KPK koha e kaluar në paraburgim që nga 29 tetor 2004 dhe derisa aktgjykimi të marrë formën e prerë është llogaritur si pjesë e dënimit me burgim;

Aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar plotësisht dhe ankesat e të pandehurit, avokatit të tij mbrojtës dhe Prokurorit Publik janë refuzuar në shkallën e dytë me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (Ap.-Kz. Nr. 364/2010, të datës 12 prill 2011).

I pandehuri, me datë 22 qershor 2011, ka ushtruar ankesë në kohë kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 12 prill 2011 (Ap.-Kz. Nr. 364/2010); u pohua se aktgjykimi përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim jo të plotë të fakteve, shkelje të ligjit penal dhe se sanksioni penal i shqiptuar ishte i padrejtë. I pandehuri propozon për të rishqyrtuar lëndën sepse ai nuk e ka privuar nga jeta viktimën K.Z..

ZPShK, me përgjigjen e datës 04 tetor 2011 dhe të regjistruar në Shkrimoren e Gjykatës Supreme të Kosovës të njëjtën ditë kundërshtoj tërësisht të gjitha aspektet e ankesës si të pabazuara dhe prandaj propozon të refuzohet ajo dhe të vërtetohet aktgjykimi i kontestuar në lidhje me **A.O.**

Bazuar në aktgjykimin me shkrim të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në lëndën nr. P. Nr. 64/2005 të datës 30 nëntor 2009 (të paraqitur në Shkrimoren e gjykatës të njëjtën ditë), dhe aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (Ap.-Kz. Nr. 364/2010, të datës 12 prill 2011), ankesën e parashtuar me shkrim të të pandehurit, shkresat dhe dokumentet relevante të dosjes si edhe parashtresat verbale të palëve gjatë seancës më 21 shkurt 2012, bashkë me analizën e ligjit në fuqi, Gjykata Supreme e Kosovës pas këshillimit të mbajtur të njëjtën ditë, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Ankesa e ushtruar nga i pandehuri A.O. më 24 qershor 2011 kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AP.-KZ. Nr. 364/2010, të datës 12 prill 2011, REFUZOHET SI E PABAZUAR. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. Nr. 64/2005, i datës 30 nëntor 2009, në formën e aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AP.-KZ. Nr. 364/2010, i datës 12 prill 2011, VËRTETOHET.

ARSYETIMI

Historia e Procedurës

1. Gjatë pasdites të datës 28 tetor 2004, në fshatin Bardhë i Madh, komuna Fushë Kosovë, në vendin e quajtur “Te Kalaja” viktima e ndjerë K.Z. 20 vjeç, nga fshati Halilaq, është privuar nga jeta nga përdorimi i një revolveri të markës së pa definuar, të kalibrit 9x19 mm, duke qëlluar 12 herë në trupin e tij. Dhjetë plumba shkaktuan plagë depërtuese, ndërsa dy të tjerë goditën pjesën kurrizore të trupit, e cila - sipas raportit të autopsisë të datës 29 dhjetor 2004 - çoi në vdekjen e menjëhershme të viktimës. Trupi i vdekur i viktimës, i cili për herë të parë është raportuar në polici nga familja e tij si vetëm i humbur - u zbulua përfundimisht më 20 dhjetor 2004, i hedhur në një gropë me ujë me madhësi 3.40mx4.80m afër fshatit Bardhë i Madh dhe pjesërisht i mbuluar me qese dhe dhe’.

2. Bazuar në rezultatet e procedurës së provave, Prokuroria Publik e Qarkut në Prishtinë ngriti aktakuzë kundër të pandehurit A.O., duke e akuzuar atë për Vrasje të Rëndë të K.Z. dhe një tjetër bashkë të pandehuri për Dhënie të Ndihmës në Vrasje të Rëndë, sepse ai gjoja e kishte ndihmuar të fshehte kufomën.

3. Aktakuza është konsoliduar me vendimin për konfirmim të gjykatës së shkallës së parë më 29 nëntor 2005.

4. Shqyrtimi gjyqësor i hapur kundër dy të pandehurve, **A.O.** dhe bashkë i pandehuri i tij, filloi më 20 mars 2006 dhe filloi nëpërmjet 22 seancave, ky këto të fundit u zhvilluan më 21 mars, 27 prill, 07 qershor, 17korrik, 04 shtator, 09 tetor, 09 nëntor, 13 nëntor, 18 dhjetor 2006, 17 janar, 05 mars, 23 prill, 04 Qershor, 25 qershor, 30 shtator, 22 tetor, 27 nëntor, 17 dhjetor 2007, 6 Mars, 07 prill, 26 maj dhe 24 qershor 2008. Për shkak të mospasjes në dispozicion të paparashikuar të Kryetarit të kolegjit, gjykim nuk është përfunduar dhe çështja është dashur të rifilloj me gjyqtaren Marije Ademi si Kryetare e kolegjit.

Pasi që i pandehuri **A.O.** pa sukses ushtroi shumë kërkesa në lidhje me caktimin e gjyqtarëve ndërkombëtarë në lëndë, lënda – pas marrjes nga EULEX-i –përfundimisht me vendim të Kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it të datës 24 prill 2009 iu caktua kolegjit në përbërje me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it. Ky i fundit rifilloi gjykimin nga data 04 korrik 2009 e tutje.

5. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata e shkallës së parë mori në pyetje të pandehurin, **A.O.** më 10 nëntor 2009, pastaj u dëgjuan dëshmitarët M.Z. dhe M.B. (22 qershor 2009), S. dhe O.Z., M.G. dhe L.B. (29 qershor 2009), H.O., F.G., B.S. dhe S.S. (10 gusht 2009), B.G., S.Q., F.B. dhe N.M. (11 gusht 2009), S.J., A.M. dhe dëshmitari ekspert Dr. T.G. (13 gusht 2009), dëshmitarët ekspert Dr. T.G. dhe H.K. si edhe i bashkë akuzuari F.B. (01 shtator 2009).

6. Bazuar në provat e marra, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike e cila ka shpie deri tek dënimet e paraqitura më herët. Bazuar në konstatimet e saj, më 24 nëntor 2009, Gjykata e Qarkut prezantoi aktgjykimin duke e shpallur të akuzuarin fajtor

për veprën penale të Vrasjes së Rëndë siç është radhitur më lart. Si pasojë, gjykata i ka shqiptuar dënimin të akuzuarit që gjithashtu është specifikuar më lart.

7. Aktgjykimi është ankimuar me kohë nga Prokurori i Qarkut në Prishtinë më 27 shtator 2009 dhe nga të dytë, avokati mbrojtës i **A.O.t**, Av. F.H. më 6 tetor 2010 dhe i pandehuri **A.O.** më 12 tetor 2009.

8. Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK) në opinionin dhe propozimin e ankesave argumentoi që ankesat e ushtruara në emër të të pandehurit **A.O.** janë të pabazuara prandaj edhe duhet të refuzohen, derisa aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut duhet të vërtetohet.

9. Më 12 prill 2011, kolegji i ankesave të Gjykatës Supreme të Kosovës shpalli aktgjykimin e tij (Az.-Kz. 364/2010), kështu duke refuzuar ankesat e të pandehurit, avokatit të tij mbrojtës dhe të Prokurorit Publik dhe duke vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në lëndën P.nr. 64/2005 të datës 30 nëntor 2009.

10. **I pandehuri** më datën 22 qershor 2011 parashtroi me kohë ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 12 prill 2011 (Ap.-Kz.nr. . 364/2010), duke pohuar shkelje esenciale të procedurës penale, vërtetimin jo të plotë të fakteve, shkeljen e ligjit penal dhe që sanksioni i shqiptuar penal do të ishte i padrejtë siç është nënvizuar më parë. I pandehuri propozon rishikimin e lëndës, sepse ai nuk e privuar nga jeta viktimën K.Z..

11. **ZPShK-ja** në përgjigje të datës 4 tetor 2011 dhe të regjistruar me shkrimoren e Gjykatës Supreme të Kosovës të njëjtën ditë në tërësi ka kundërshtuar të gjitha aspektet e ankesës si të pabazuara prandaj edhe ka propozuar që të refuzohet dhe të vërtetohet aktgjykimi i kontestuar në lidhje me **A.O.n**, siç është paraqitur më parë.

12. Në seancës ankimore të shkallës së tretë të Gjykatës Supreme të Kosovës më 21 shkurt 2012, avokati mbrojtës e gjithashtu edhe përfaqësuesi i ZPShK-së i kanë bërë referencë të plotë parashtrësive të tyre me shkrim. I pandehuri **A.O.** ka dhënë deklaratë të gjatë dhe të hollësishme, brenda së cilës në mënyrë shumë të hollësishme ai ka vënë në pah që nën organizatorin (trurin) e L.P., ai e gjithashtu edhe bashkë-i pandehuri i mëparshëm F.B. kanë planifikuar t'i vënë kurth, ta kidnapojnë dhe përfundimisht të vrasin tani viktimën e ndjerë K.Z., por ai që ka tërhequr këmbëzën dhe qëlluar viktimën për vdekje ishte L.P.. Referencë i është bërë përsëri sasisë së pretenduar të drogës që ka qenë subjekt i konfliktit në mes të viktimës dhe në veçanti L.P.. Pastaj i pandehuri ka përshkruar se si ai së bashku me F.B. e kanë hedhur kufomën e viktimës K.Z. në një gropë me baltë dhe e kanë mbuluar me dhe, mbeturina dhe në veçanti me piper, e tëra kjo sipas këshillës së L.P.. Për më tepër, i fundit ka premtuar që të paguaj shumë 25.000 për të dytë, të pandehurin **A.O.** dhe F.B. që të marrin pjesë në veprën përkatëse penale. Përfundimisht, i pandehuri **A.O.** mohoi që ai ndonjëherë ka qenë i punësuar në aeroport.

GJETJET E GJYKATËS

A. Kompetenca e Gjykatës Supreme të vendos për lëndën në seancë

13. Lidhur me deklaratën e gjatë dhe të hollësishme të të pandehurit para kolegjit të Gjykatës Supreme më 21 shkurt 2012, është ngritur pyetja nëse duhet apo jo që kjo deklaratë teknikisht të konsiderohet si rrëfim, kështu duke e shtyrë kolegjin të vlerësoj këtë si një provë të re në pajtim me nenin 412, paragrafin 12 të KPPK-së gjatë rrjedhës së shqyrtimit.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton që kjo nuk ka të bëjë me këtë. Kolegji në fillim ka ardhur tek opinioni që deklarata përkatëse e të pandehurit teknikisht nuk duhet të cilësohet si rrëfim, por është vetëm një deklaratë tjetër e të pandehurit në vazhdimësi me së paku tetë versione të mëparshme të situatës mbi bazën siç është dhënë para policisë, Prokurorit Publik dhe më vonë në gjykatë në mes të 28 tetorit 2004 dhe 16 dhjetor 2004 e gjithashtu edhe më 10 nëntor 2009. Referencë i është bërë listës së deklaratave që përfshihen në aktgjykimin e shkallës së parë (fq.19 deri në fq. 20 të versionit në gjuhën angleze). I pandehuri nuk ka deklaruar që ai tani dëshiron të rrëfëhet, por në vend të kësaj ka thënë që do të dëshironte t'i zbuloj disa sekrete që ai gjithmonë i ka mbajtur për vete deri më tani, pastaj duke treguar ngjarje të cilat tashmë i ka thënë disa herë më parë, por tani me ndryshime të vogla sa i përket rolit të tij në kontekstin e krimit të kryer. Gjithashtu propozimi i tij nuk ishte i fokusuar për të mbajtur shqyrtim për rrëfimin e tij, por për t'u zbatuar një dënim më i butë ndaj tij, i cili do të ishte në lidhje të duhur me kontributet e tij në veprën penale në fjalë.

Përkundër tërë kësaj, referencë i është bërë nenit 430, paragrafit 2, fjalisë së fundit të KPK-së, sipas së cilës në nivelin e ankesës kundër aktgjykimin të shkallës së dytë "*Në Gjykatën Supreme nuk mund të mbahet shqyrtim*". Kjo dispozitë e përjashton mundësinë e paraqitjes së provave të reja në këtë shkallë.

Prandaj, Gjykata Supreme i referohet aspekteve siç janë theksuar në ankesën e të pandehurit, të bazuar në seancën e mbajtur më 21 shkurt 2012.

B. Shkelja substanciale e dispozitave të Procedurës Penale

I. DISPOZITIVI I AKTGJYKIMIT TË SHKALLËS SË DYTË

1. Kuptueshmëria dhe pajtueshmëria e dispozitivit:

14. I pandehuri në ankesën e tij ka vënë në pah që dispozitivi i aktgjykimin të shkallës së dytë është i paqartë dhe i pakuptueshëm e gjithashtu kontradiktor në vete dhe në arsyetim të aktgjykimin. Në veçanti, arsyetimi i Gjykatës Supreme do të jepte përshtypje që kolegji ankimorë nuk ka pasur shumë dashje dhe durim që në mënyrë të plotë të ekzaminoj gjithçka që ka qenë substanciale në lëndë. Prandaj, **Gjykata Supreme ka shkelur nenin 403, paragrafin 2, pikën 12 të KPPK-së.**

15. Ky kolegji i Gjykatës Supreme fillimisht konstaton që dispozitivi i aktgjykimin të shkallës së dytë i plotëson të gjitha kërkesat e KPPK-së dhe në veçanti është absolutisht

i qartë dhe i kuptueshëm. Nuk është as i dykuptimshëm e as në kontradiktë me aktgjykimin e shkallës së dytë.

Në veçanti, neni 396, paragrafët 3 dhe 4 të KPPK-së thotë si në vijim:

(3) Dispozitivi i aktgjyimit përfshin të dhënat personale të të akuzuarit (neni 233, paragrafi 1 i këtij Kodi) dhe vendimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, ose me të cilin lirohet nga akuza për atë vepër apo me të cilin referohet aktakuza.

(4) Kur i akuzuari është dënuar, dispozitivi i aktgjyimit përfshin të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara në nenin 391 të këtij Kodi, ...

Neni 391, paragrafi 1 i KPPK-së – aq sa është relevant në lëndën në fjalë – thotë si në vijim:

Gjykata, në aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e shpall fajtor shënon:

1) Për cilën vepër shpallet fajtor së bashku me faktet dhe rrethanat që përbejnë figurën e veprës penale si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal;

2) Emërtimin ligjor të veprës penale dhe dispozitat e ligjit penal të zbatuara gjatë marrjes së aktgjyimit; ...

Aktgjykimi përkatës i shkallës së dytë sa i përket pikës së diskutimit pas refuzimit të dyja, ankesat e të pandehurit dhe të avokatit të tij mbrojtës kundër aktgjyimit të Gjykatës së Qarkut e gjithashtu edhe ankesa e prokurorit, në tërësi e vërteton “aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në lëndën P.nr. 64/2005, të datës 30 nëntor 2009”.

Duhet të merret parasysh që aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së dytë në përpikëri i referohet shqetësimeve që janë ngritur nga mbrojtja kundër aktgjyimit të shkallës së parë dhe kështu në linjë me dispozitën e nenit 415, paragrafit 1 të KPPK-së duke përcaktuar që *gjykata e shkallës së dytë duhet të ekzaminoj pjesën e aktgjyimit, i cili është kundërshtuar me ankesë*. Prandaj, vlen të përmendet që dispozitivi i aktgjyimit të shkallës së dytë pa asnjë dyshim i përbush të gjitha kërkesat e nenit 396, paragrafit 3 të KPPK-së, pasi që ekzistojnë në veçanti të dhëna personale të të akuzuarit në pajtim me nenin 233 të KPPK-së dhe vendimi sipas të cilit ai është shpallur fajtor i veprës për të cilën ishte akuzuar. Lidhur me të fundit, është vërtetuar që aktgjykimi i shkallës së dytë në tërësi i referohet aktgjyimit të kundërshtuar të Gjykatës së Qarkut, i cili është vërtetuar.

Prandaj, ky kolegji i Gjykatës Supreme vëren që dispozitivi i aktgjyimit të kundërshtuar të shkallës së dytë është mjaft i qartë që t’i qëndroj kundërshtimeve mbi kuptueshmërinë dhe lidhjen logjike (pajtueshmërinë) e tij.

2. Kundërthëniet në brendinë dhe mangësitë e arsytimit të aktgjykimit:

16. Për më tepër, i pandehuri ka theksuar se sipas mendimit të tij arsytimi i aktgjykimit të shkallës së dytë është në kundërthënie me vetveten dhe përmban mangësi. Në veçanti, kolegji për ankesa nuk ka pasur gatishmëri dhe durim për t'i ekzaminuar të gjitha në hollësi, e që në këtë lëndë një gjë e tillë ka qenë tejet e rëndësishme.

17. Kolegji i Gjykatës Supreme gjen se në të vërtetë arsytimi i gjykatës së shkallës së dytë është mjaft i shkurtër në secilën pikë të ankesës. Megjithatë, aktgjykimi i kundërshtuar është shumë i qartë dhe i saktë lidhur me secilën pikë, duke reflektuar me kujdes mbi të gjitha aspektet relevante të aktgjykimit shumë të detajuar të shkallës së parë. Në veçanti, kjo e fundit mund të lexohet prej faqes 5 deri në 7 të aktgjykimit të kundërshtuar të Gjykatës Supreme (në versionin në gjuhën angleze). Në veçanti, nuk ka asnjë indikacion të shkeljes së nenit 403 paragrafit 1, pikës 12 të KPPK-së, pasi që nuk mund të vërtetohet asnjë kundërthënie në mes të dispozitivit si të tillë, ose në mes të dispozitivit dhe arsytimit të aktgjykimit sa i përket cilësimit juridik të veprës penale për të cilën **A.O.** është shpallur fajtor.

II. VLERËSIMI DHE MARRJA NË KONSIDERATË E GABUAR E PROVAVE

18. Në të njëjtën kohë, i pandehuri është i mendimit se aktgjykimi i kundërshtuar i shkallës së dytë nuk ka vlerësuar në mënyrë të duhur dëshmitë siç janë dhënë nga vetë i pandehuri dhe se në vend të kësaj gjykata i është referuar dëshmitarëve jo të besueshëm.

Kolegji i Gjykatës Supreme arrin në përfundim se nuk ka pasur vlerësim dhe marrje në konsideratë të gabuar të provave, as nga gjykata e shkallës së parë e as nga kolegji i shkallës së dytë të Gjykatës Supreme.

Ekzaminimi i dosjes na mundëson të konstatojmë se tanimë gjykata e shkallës së parë ka analizuar me kujdes të gjitha provat fizike në dispozicion si dhe dëshmitë e dëshmitarëve dhe të pandehurit, dhe i ka peshuar ato në lidhje me të gjitha aspektet një nga një. Në veçanti, referencë i bëhet prej faqes 9 deri në faqen 26 të aktgjykimit të shkallës së parë (në versionin në gjuhën angleze). Gjithashtu, gjykata e shkallës së dytë ka gjetur se Gjykata e Qarkut ka dhënë një vlerësim të detajuar dhe të hollësishëm të provave.

C. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

19. I pandehurit ka theksuar se vërtetimi i gjendjes faktike ka qenë i gabuar dhe jo i plotë. Kolegji i Gjykatës Supreme në veçanti nuk kishte vlerësuar në mënyrë të duhur dëshminë e të pandehurit sipas të cilit vrasja e viktimës K.Z. ishte kryer nga L.P.. Për më tepër, ai gjithashtu ka theksuar se disa prova ishin humbur. Në veçanti, ekspertiza e datës 29 tetor 2004 thjeshtë ishte “zhdukur” gjatë procedurës së shkallës së parë. Gjithashtu, kolegji i shkallës së dytë nuk ka marrë parasysh në mënyrë të duhur se sipas dëshmisë së të pandehurit para gjykatës së shkallës së parë, çelësat e veturës ishin në shtëpinë e F.B. dhe se dëshmia e ndryshme e M.B., sipas të cilës çelësat e veturës ishin me të pandehurin, është e gabuar. Gjykata Supreme nuk ka marrë në konsideratë

dëshminë e të pandehurit se thirrjet telefonike nga ai tek viktimja K.Z. nuk ishin bërë me iniciativën e të pandehurit, por me forcë.

20. Referencë i është bërë asaj që tanimë është theksuar më parë, mirëpo në aspekte të ndryshme. Në lëndën në fjalë nuk ka asnjë indikacion se gjykata e shkallës së dytë nuk e ka vërtetuar gjendjen faktike drejtë dhe në mënyrë të plotë ose që nuk ka vlerësuar në mënyrë të duhur vërtetimin e gjykatës së shkallës së parë. Në aktgjykimin e kundërshtuar mund të lexohet se gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar me kujdes “*provat në shkresat e lëndës [...] duke i krahasuar me gjetjet faktike të aktgjyimit të ankimuar*” (faqe 7 e versionit në gjuhën angleze). Kontrollimi i aktgjyimit të shkallës së parë dhe procesverbalit të seancave të gjyimit në shkresat e lëndës sjellë në konstatim se vlerësimi i lartpërmendur i gjykatës së shkallës së dytë është i bazuar mirë në shkresat e lëndës.

E fundit por jo më pak e rëndësishme, referencë i bëhet konstatimit në lëndën R., A. dhe D. (Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZ 477/05 i datës 25 janar 2008, f.20 (versioni në gjuhën angleze), sipas të cilit “*Procedura ankimore sipas KPPK-së mbështetet në parimin se është detyrë e trupit gjykues që të dëgjojë, vlerësojë dhe peshojë provat gjatë gjyimit. [...]. Prandaj, nga gjykata e apelit kërkohet që t’i jap trupit gjykues hapësirë të mjaftueshme për arritjen e gjetjeve faktike. Ajo nuk duhet t’i trazoj gjetje e trupit gjykues duke i zëvendësuar ato me të vetat, përveç nëse provat në të cilat janë bazuar nuk do të ishin të pranueshme për asnjë gjykatë të arsyeshme të faktit, ose kur vlerësimi i tyre ka qenë “tërësisht i gabuar”*. Ky gjykim është përsëritur dhe është zhvilluar më tutje në lëndët tjera në veçanti në lëndën kundër F.E. (Gjykata Supreme e Kosovës, Pkl-Kzz 71/09 i datës 10 tetor 2009) dhe kundër J.K. (Gjykata Supreme e Kosovës, Ap.-Kz. Nr. 84/2009 i datës 03 dhjetor 2009).

D. Shkelja substanciale e Ligjit penal

21. I pandehuri është i mendimit se për shkak të dështimeve të pretenduara të kolegjit të Gjykatës Supreme, ky i fundit gjithashtu ka shkelur edhe Ligjin penal.

22. Kolegji i referohet asaj që është theksuar më herët, Pasi që nuk është vërtetuar asnjë shkelje në lidhje me ligjin e procedurës dhe vërtetimin e fakteve, nga kjo nuk mund të ngritet asnjë konkluzion i cili shpie në shkelje të ligjit penal.

Edhe duke marrë parasysh dëshminë e të pandehurit A.O. sipas të cilit nuk ka qenë ai por L.P. ai i cili përfundimisht ka shtënë për vdekje në viktimën K.Z., nuk ka nevojë që të bëhet asnjë ri-cilësim i përgjegjësisë penale të të pandehurit. Duke pasur parasysh se vënia në kurth dhe vrasje e K.Z.t ka qenë pjesë e një plani të përbashkët i cili gjithashtu është ndarë edhe nga i pandehuri A.O., nuk është me rëndësi se kush përfundimisht e ka tërhequr këmbëzën.

E. Vendimi mbi dënimin

23. I pandehuri ka shprehur mendimin e tij se dënimi i shqiptuar është i papërshtatshëm dhe tepër i ashpër dhe se së paku duhet të zvogëlohet në mënyrë të konsiderueshme, në rast se vërtetohet se ai i ka kryer krimet për të cilat akuzohet.

24. Ndryshe nga kjo, pala e dëmtuar ka propozuar rritjen e dënimit deri në shkallën më të lartë të mundshme, duke e pasur parasysh se i pandehuri nuk i ka kërkuar as falje familjes së viktimës.

25. Vendimi mbi dënimin konsiderohet i drejtë, i caktuar në mënyrë të duhur dhe jo i jashtëzakonshëm për aq sa mund të bazohet në gjetjet e gjykatës së shkallës së dytë. Asnjëra nga shkallët e mëparshme nuk ka dështuar që t'i marrë parasysh rrethanat lehtësuese në dobi të të pandehurit. Pasi që asnjëra nga dëshmitë e tij të ndryshme nuk mund të konsiderohet si pranim teknik, ato nuk mund të shpijnë në zvogëlimin e dënimit. Në anën tjetër, nuk ekzistojnë arsye substanciale për rritjen e dënimit siç është propozuar nga pala e dëmtuar. Prandaj, kolegji i Gjykatës Supreme e ndan vlerësimin e bërë nga kolegji i shkallës së dytë, i cili ka vërtetuar vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë.

F. Përfundimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

26. Në bazë të arsyeve të lartpërmendura, Gjykata Supreme përfundon se ankesa e të pandehurit A.O. është e pabazuar.

Si rrjedhojë, Gjykata Supreme ka vendosur në pajtim me nenin 430 paragrafin 2 në lidhje me nenin 420 paragrafin 1, pikën 2, 423 të KPPK-së

Në bazë të arsyeve të lartpërmendura, Gjykata Supreme ka vendosur si në dispozitiv.

Gjykata Supreme e Kosovës
API.-KZI. Nr. 7/2011
Prishtinë
21 shkurt 2012

Anëtarët e kolegjit:

Anne Kerber
Gjyqtare e EULEX-it

Nazmije Ibrahim
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Gyltene Sylejmani
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Salih Toplica
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Kryetar i kolegjit:

Gerrit-Marc Sprenger
Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtës

Holger Engelmann
Zyrtar ligjor i EULEX-it